

Nr. 2302/08 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 11/02/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **KONSTATIME** – Raporti IV i
Gjetjeve dhe Rekomandimeve për
javën 3 shkurt - 9 shkurt 2023,
lidhur me raportimet në
ndërfaqen e raportimeve të KQZ-
së të veprimtarive me karakter
publik të institucioneve publike,
agjencive dhe/ose ndërmarrjeve
shtetërore.

I Nderuar Z. Komisioner!

Të nderuar kolegë të administratës së KQZ-së!

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në vazhdimësi, mund të gjeni në vijim Gjetjet dhe Rekomandimet e Raportit të monitorimit të KRIIK për javën e katërt të funksionimit të mekanizmit të raportimit të institucioneve në ndërfaqe, për periudhën 3 - 9 shkurt 2023.

Gjatë monitorimit të javës së katërt të funksionimit të ndërfaqes, KRIIK ka evidentuar disa problematika të cilat lidhen me:

- 1. Mosrespektimin e afatit ligjor 5 ditor përpara zhvillimit të aktivitetit;**
- 2. Kryerjen e veprimtarive publike, pavarësisht se nuk janë raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së;**
- 3. Kryerjen e aktiviteteve përpara datës së raportuar për zhvillimin e tij.**

Konkretisht:

1. Raportimi i aktiviteteve me vonesë

Praktika e raportimit të aktiviteteve me vonesë (më pak se pesë ditë në dispozicion të KQZ-së përpara ditës së aktivitetit) vijon edhe në këtë javë të katërt.

Nga monitorimi i KRIIK rezulton se **rreth 40% e raportimeve në javën e tretë (3 shkurt - 9 shkurt) janë me vonesë.**

Specifikisht, nga 227 aktivitete të raportuara nga data 3 shkurt deri në datën 9 shkurt 2023, 91 janë raportuar me vonesë (për më shumë shih **Lidhjen 1**, e cila përmbledh të dhënat për raportimet me vonesë, si dhe **Lidhjen 2** me listën e detajuar të këtyre aktiviteteve, së bashku me të dhënat përkatëse referuar ndërfaqes së aktiviteteve në faqen e internetit të KQZ-së).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Numri total i institucioneve raportuese përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport është 47, nga të cilat 34 kanë raportuar së paku një aktivitet përtej afatit të përcaktuar ligjor.

KRIIK shpreh sërish shqetësimin dhe nevojën për adresimin e duhur nga KQZ të problematikës së vonësve në raportime.

Ky adresim duhet bërë sa më parë, në mënyrë që të ndikojë në mënyrë efikente në raportimin në vijim për 12 javët e mbetura, ku, me shumë gjasë, **problematikat do të shtohen e masivizohen** në mungesë të një qasje proaktive prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

KRIIK vlerëson vendimmarrjet për propozimin e sanksioneve bazuar në procesin e hetimeve administrative të zhvilluara, por është i mendimit se ka ende shumë për të bërë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përsa i përket kontributit dhe përvojës së KRIIK lidhur me mënyrat e adresimit të kësaj problematike, rikujtojmë se **KRIIK ju ka përcjellë Rekomandime konkrete**, qoftë në nivel politik e të përgjithshëm, qoftë në nivel teknik e konkret, nëpërmjet e-maileve të dërguara me Raportet e Monitorimit të tre javëve të para, përkatësisht të datave 21, 28 janar dhe 4 shkurt 2023.

2. Veprimtari publike të zhvilluara, por të paraportuara

KRIIK ka vijuar edhe përgjatë kësaj jave, të kryejë një monitorim jo sistematik të faqeve zyrtare të disa institucioneve në mediat sociale, si dhe të mediave të tjera online lidhur me pasqyrimin e aktivitetit institucional të këtyre institucioneve.

Gjatë periudhës 3 – 9 shkurt 2023, rezulton se së paku 21 veprimtari publike nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së. *(për më tepër gjeni bashkëlidhur **Lidhjen nr. 3 me listën e këtyre aktiviteteve së bashku me informacione shtesë të pasqyrimeve mediatike që provojnë realizimin e tyre**).*

Lidhur me këtë konstatim, KRIIK risjell në vëmendjen tuaj se:

- Konstatimi bazohet në gjykimin se këto aktivitete nuk janë raportuar, pasi ato nuk pasqyrohen në informacionin e bërë publik në ndërfaqen e KQZ-së.
- Me shumë gjasë numri i aktiviteteve të pa raportuara duhet të jetë më i lartë, pasi siç u citua më sipër, aktivitetet e gjetura bazohen në një monitorim të kryer në mënyrë jo sistematike.

Bazuar në këto gjetje, duke qenë se situata mbetet e njëjtë, KRIIK risjell **Rekomandimin** e paraqitur tanimë në Raportet pararendëse se “nevojitet që **KQZ-ja nëpërmjet veprimeve institucionale dhe vendimmarrjeve të nevojshme të sigurojë dhe propagandojë zbatimin pa ekuivok të ligjit**, ndërkohë që duhet edhe të rrisë mënyrat e ndërgjegjësimit paraprakisht për zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara për tu përmbushur nga aktorët institucionalë.”

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

3. Kryerja e aktivitetit përpara datës së raportuar për zhvillimin e tij

Nga monitorimi i kryer është vërejtur një problematikë e re. Në disa raste aktiviteti është zhvilluar përpara datës së raportuar për zhvillimin e tij.

Janë konstatuar së paku 4 aktivitete të tilla të cilat renditen në vijim:

- Kryetari i Bashkisë Berat [ka postuar në faqen e tij në Facebook](#), zhvillimin e një aktiviteti “Sot e kaluam ditën në shkollën jopublike “Irfan Ngjeqari”.
Postimi mban datën 3 shkurt 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar ose në datën 3 shkurt ose përpara kësaj date.
Ndërkohë nga [konsultimi i ndërfaqes së raportimeve të KQZ](#), rezulton se në datën 6 shkurt 2023 Bashkia Berat ka raportuar për një aktivitet me temë “Vizitë në shkollën jo publike “Irfan Ngjeqari”, me stafin akademik, maturantët etj”, të cilin planifikon ta zhvillojë më datën 20 shkurt 2023.
- Sërish, Kryetari i Bashkisë Berat, z. Ervin Demo ka postuar [në faqen e tij në Facebook](#), zhvillimin e një aktiviteti “Vizitë e këndshme sot në shkollën jopublike “Drita e Dijes”.
Postimi mban datën 1 shkurt 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar ose në datën 1 shkurt ose përpara kësaj date.
Ndërkohë nga konsultimi i [ndërfaqes së raportimeve të KQZ](#), rezulton se në datën 6 shkurt 2023 Bashkia Berat ka raportuar për një aktivitet me temë “Vizite ne shkollen jopublike “Drita e Dijes” me stafin edukues, maturante etj”, të cilin planifikon ta zhvillojë më datën 17 shkurt 2023.
- Bashkia Roskovec ka [postuar në faqen Facebook të institucionit](#), zhvillimin e inspektimit të shkollës 9-vjeçare “5-Dëshmorët” Suk 1.
Postimi mban datën 24 janar 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar ose në datën 24 janar ose përpara kësaj date.
Ndërkohë nga konsultimi i [ndërfaqes së raportimeve të KQZ](#), Bashkia Roskovec ka raportuar në datën 20 janar 2023 për zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim i punimeve ne objektin “Shkolla 9 vjecare 5 Deshmoret”, Suk 1, Roskovec”, të cilin planifikonte ta zhvillonte në datën 27 janar 2023.
- Bashkia Tiranë ka [postuar në faqen Facebook të institucionit](#), zhvillimin e inspektimit të Kryetarit të bashkisë në godinat e Qytetit Studenti, me titullin: Në “Qytetin Studenti” po ndërtojmë tri godina të reja pritëse për studentët”.
Data e postimit është 4 shkurt 2023, çka nënkupton që aktiviteti është zhvilluar në këtë datë ose më herët.
Ndërkohë nga konsultimi i [ndërfaqes së raportimeve në KQZ](#), Bashkia Tiranë ka raportuar në datën 3 shkurt 2023 zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim punimesh konviktesh”, të cilin planifikonte ta zhvillonte në datën datën 8 shkurt 2023.

Nga katër aktivitetet e mësipërme, dy të fundit kanë deklaruar datë të planifikuar për zhvillimin e tyre, një datë e cila tashmë ka kaluar.

Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarëve dhe institucioneve përkatëse, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Pra, rezulton se aktivitetet janë kryer dhe datat e deklaruara për zhvillimit e tyre, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, **ka qenë të plotësuara gabim.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të thellohet** në hetimin administrativ të këtyre rasteve.

Në rastin më të mirë, gjykohet se gabimi në datën e raportuar mund të jetë një gabim njerëzor ose një ndryshim i agjendës së punës së institucionit pasi është bërë raportimi në ndërfaqe.

Në këtë rast, për të dy aktivitetet, duhet proceduar si ndaj aktiviteteve të cilat janë raportuar në shkelje të afatit ligjor.

Ndërkohë, nga ana tjetër, duke parë edhe numrin e rasteve, **ngrihen dyshime se mund të jenë aktivitete të cilat raportohen qëllimisht me datë zhvillimi fiktive**, në mënyrë që të mos çenohet afati 5 ditor i raportimit në ndërfaqe, meqënëse kjo e fundit kontrollohet me rigorozitet nga KQZ-ja.

Ky rast duhet të nxisë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të parandaluar dhe marrë masa konkrete për të moslejuar përsëritjen dhe masivizimin e kësaj mënyre të raportuari, e cila mban edhe përgjegjësinë e mashtrimit në vetvete.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania